

STUDIMET NË ZVICËR

STATUSI I STUDENTËVE TË HUAJ (që vijnë nga shtetet jashtë BE); A MUND TË FITOHET LEJA E PUNËS PAS PËRFUNDIMIT TË STUDIMEVE ?

Sipas disa rregullave tejet të ashpra ligjore, në të kaluarën, një student i huaj (posaçërisht me origjinë nga shtetet jashtë BE, si për shembull, nga disa vende ballkanike), i cili i përfundonte studimet univerzitare apo ndonjë shkollë të lartë të nivelit ekuivalent, ishte i detyrur që të lëshojë territorin zviceran, menjëherë pas përfundimit të studimeve.

Aplikohej pikërisht një rregullë sipas së cilës konsideroheshte se arsyet për një qëndrim të mëtutjeshëm kanë përfunduar, pasi që leja e qëndrimit për studentët e tillë akordohej me të vetmin qëllim që t'iu mundësohet atyre që të shkollohen në Zvicër dhe pas diplomimit të kthehen në vendin e tyre të origjinës.

Kjo situatë pësoi disa ndryshime të rëndësishme me hyrjen në fuqi të një dispozite të re ligjore. Kështu që ligjit për të huaj (aplikueshmëria e së cilit shtrihet vetëm tek personat që vijnë jashtë shteteve të BE), që nga janari 2011, i shtohet një dispozitë specifike (në nenin 21 të tij), e cila parashikon që personave të tillë të cilët i përfundojnë studimet t'iu lejohet të vazhdojnë të qëndrojnë edhe për gjasht muaj pas diplomimit, me qëllim që t'iu mundësohet kështu që të kërkojnë ndonjë punë apo aktivitet profesional që do të përputhej me titullin e fituar.

Duhet me theksuar atë se vetëm të diplomuarit që mundë të aspirojnë ndonjë aktivitet të rëndësishëm, në këndvështrimin ekonomik apo shkencor, mundë të përfitojnë një leje pune. Në kontekstin aktual të zhvillimit ekonomik të vendit, një inxhinjer në informatik, për shembull, dhe njohës i disa gjuhëve, do të kishte më tepër gjasa të nxjerrë lejen e punës, në krahasim me dikëndin i cili ka kryer studime në një drejtim i cili nuk ofron oportunitete të mjaftueshme në tregun e punës.

Ajo çka vlenë të ceket për dispozitën e tillë, është edhe fakti se kjo rregullë e re, këtë kategori të të diplomuarëve, gjatë formaliteteve të kërimit të punës, e vënë në një pozitë të barabartë me personat që posedojnë një status të rregulluar të qëndrimit. Me fjalë të tjera, nuk aplikohet parimi i përparsisë së statusit të qëndrimit, gjatë procesit të angazhimit në punë. Kryesorja është pra të gjindet puna e përshtatshme !

Por, një vazhdim i lejes në rastet e tilla nuk është i pakushtëzuar. Kërkohej, në mes tjerash, që personi i interesuar të posedojë mjete të mjaftueshme financiare të jetesës, gjatë periudhës së vazhdimit të lejës. Përndryshe, gjatë këtyre gjasht muajve, lejohet të ushtrohet ndonjë aktivitet pune prej 15 orë maksimum në javë.

Nëse mbrenda afateve të parapara, personi interesuar nuk arrinë që të gjejë punë, ligji parashikon që e drejta për fitimin e lejës së punës të humbet. Në parim, autorizimi gjasht mujor nuk mundë të vazhdohet.

Në planin praktik, nuk janë të rralla rastet kur personat që iu nënshtrohen këtyre rregullave, gjejnë ndonjë aktivitet pune para se t'i përfundojnë studimet, nisur sidomos nga fakti se është sadopak vështirë të shpresohet gjetja e një punë mbrenda një afati disa mujorë.

Zyra për këshilla juridike « BEGZATI »
Av. J. J. Rousseau 7, 2000 Neuchâtel
Tel.. 079/354'67'13
www.cabinet-begzati.ch